



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XIV i botimit, nr. 152, Qershor 2016  
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## "TË GJITHË PËR RRUGEN E DUKAGJINI" 2

- Kronikë -

Me 17.6.2016, me nismën e zotit Ndue Ftoni, u mbledhen dhjetra banorë nga Dukagjini, në bar restorant "Blini" në qytetin e Shkodrës me temë: "Të gjithë për rrugën e Dukagjinit". Ishte një mbledhje e jashtëzakonshme sepse u bë një diskutim shumë popullor për një problem konkret për krahinën e Dukagjinit, siç është rruga automobilistike. E morën fjalën shumë banorë e ish banorë, të cilët vunë në dukje rëndësinë e kësaj, si domosdoshmëri për zhvillimin e gjithë krahinës. Disa e quajten edhe rruga e vdekjes, pasi vetëm në një segment prej 7 km të kësaj rruge kanë vdekur nga aksidentet 54 vetë, ndonjë edhe i huaj.



## Objekte të G. C. Scanderbeg në Paris!

Në korrikun që sapo kaloi kisha planifikuar dhe vajta për vizitë në Paris, megaqytetin që nuk e kisha vizituar prej vendimesh të shtyra herë pas here. Ashtu si çdo vizitor i këtij qyteti, edhe për arsye të kohës së shkurtër, u përpoqa të përqendrohem në vizitën e objekteve më të rëndësishme dhe më të arritshme prej aty ku banoja.

## Paraqitet libri "Dhuratë dhe angazhim.." 6

Me datën 18 qershor 2016, në orën 11.00, Arqipeshkvia Metropolitane-Shkodër-Pult, në sallën "Mikel Koliqi", organizoi ceremoninë e paraqitjes së librit "Dhuratë dhe angazhim.." pas stuhisë komuniste.

## RRUGA E DUKAGJINIT FYTYRA ESHEMIUAR ANTIPOPULLORE E POLITIKES 25 VJEÇARE 3

### SHQIPTARE!

SHKATËRRIMI DHE BRAKTISJA TOTALE DUKAGJINIT ËSHTË MARRJA E TË GJALLËVE TË SOTËM!

Para një jave ka lindur një iniciativë e re e komunitetit Dukagjinas për asfaltimin e rrugës Prekal – Breg Lumi e kantandisur në një gjendje, mjerane mizerabële dhe vdekjeprurëse për zemrën e Alpeve shqiptare: Kam qene i ftuar por për arsye pune nuk isha pjesëmarrës në atë takim i cili me sa jam i informuar me tepër se një iniciativë vullnetare për mbledhjen një X apo Y shume nga xhepat e shtjerrur te këtij komuniteti ishte një indicje për gjetjen e një donacioni serioz për çlirimin e kësaj krahine nga makthi i tmerrshëm i këtij ferri izolues shume shekullor. Nuk është rasti i pare i një nisme te tille, pasi para disa vitesh ka patur një nisme nga Bal Vuksani ku edhe u krijua një shoqate. Dje, sot, mot dhe deri sa te zgjidhjet kjo "Nyje Gordiane" që mban te lidhur për fyti Dukagjinitin jam ne vijën e pare te këtij fronti jo vetëm me mendje e zemër por edhe financiarisht sa ka vixhutin një buxhetori i rangut te mesëm te shtetit me fukara te Evropës. Sa hidhet një ide, akoma pa u artikulluar qarte fillon oponenca, dyshimet, supozimet xhelozitë ...



## AKULLORE FEST-3 4

PRANVERË ME KËNGË DHE AKULLORE NË FESTIVALIN E FËMIJËVE NË SHKODËR

U mbyll me sukses nata finale e Festivalit lokal "Akullore Fest" 3, që, megjithëse u zhvillua në një sallë me përmasa më të vogla se ajo e teatrit "Mikel Koliqi" siç është ajo ...

## 100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin 4

## PËRFAQËSIM DINTOZ I DUKAGJINIT, NË KESHILLIN BASHKIAK TË SHKODRËS 9

# “TE GJITHE PËR RRUGËN E DUKAGJINIT”

- Kronikë -

Me 17.6.2016, me nismën e zotit Ndue Ftoni, u mbledhën dhjetra banorë nga Dukagjini, në bar restorant “Blini” në qytetin e Shkodrës me temë: “Të gjithë për rrugën e Dukagjinit”. Ishte një mbledhje e jashtëzakonshme sepse u bë një diskutim shumë popullor për një problem konkret për krahinën e Dukagjinit, siç është rruga automobilistike. E morën fjalën shumë banorë e ish banorë, të cilët vunë në dukje rëndësinë e kësaj, si domosdoshmëri për zhvillimin e gjithë krahinës. Disa e quajten edhe rruga e vdekjes, pasi vetëm në një segment prej 7 km të kësaj rruge kanë vdekur nga aksidentet 54 vetë, ndonjë edhe i huaj.

Gjatë diskutimeve u vu në dukje kontributi që duhet të japim të gjithë për këtë rrugë, por dhe domosdoshmëria e ndërhyrjes së shtetit, pasi edhe kjo zonë është pjesë e këtij shteti dhe me ndihmesë të pakursyer në të gjitha etapat e historisë së Shqipërisë, duke mos kursyer as jetën. U vu në dukje se fondet qofshin vullnetare të komunitetit, siç është ndihma nga Ndue Ftoni, Paulin Sterkaj e të tjerë, apo edhe ato shtetërore, të mirë menaxhohen, e të mos ndodhin që të shpërdorohen siç mund të kenë ndodhur më parë.

Qëllimi ishte sensibilizimi jo vetëm i banorëve të Dukagjinit, por edhe i gjithë shtetasve shqiptarë, (si brenda ashtu edhe jashtë vendit), mbi mbledhjen e fondeve për zgjerimin dhe asfaltimin e rrugës Prekal-Theth.

Shkak i organizimit të nje aktiviteti të tillë u bë gjendja aktuale e rruges automobilistike nga Prekali deri në Theth. E ndërsa rruga nga Boga në Qafë Thore u asfaltua vitet e fundit, aksi tjetër rrugor prej 74 km është lënë totalisht në mëshirë të fatit.

Rruga Ura e Mesit- Breg Lumi u hap për herë të parë gjatë sistemit komunist përmes punës vullnetare dhe mundimeve të shumta që kaluan banorët. Përfundimi i saj u bë në 1972, por asnjëherë edhe pse qeveritë me pas u ndërruar, nuk e provoi fatin e asfaltimit apo të mirembajtjes. Kjo

solli amortizimin e tejskajshëm të rrugës dhe humbjen e cdo parametri normal për të udhëtuar në këtë zonë. Rrezikshmëria në segmente të ndryshme u shtua tej mase, sa që solli jetë të humbura përgjatë viteve që pasuan.

Ndue Ftoni ka vu në dispozicion të

fjalës së tij, advokati Pal Shkambi premtoj 1 milion lekë të vjetra në shërbim të kësaj rrugë. Të gjithë folësit thanë se është e pamundur që vetëm me ndihmat vullnetare të bëhet kjo punë, por duhet domosdoshmërisht ndërhyrja e shtetit.

Në këtë mbledhje shumë të mirë



kësaj rruge 20000 dollarë, Paulin Sterkaj 10 milion lekë të vjetra, ndërsa Mirash Binaku do të vënë në shërbim të kësaj rruga pa shpërbllim mjetët motorike në masën 10 përqind të të gjithë volumit të punës.

Folësit që e morën fjalën si: Dedë Toka, Ndue Sanaj, Pal Shkambi, Zef Toka, Petrit Arra, Tomë Ndoka, etj. Folen konkretisht, jashtë ndikimeve partiake, por vetëm në të mirë të Dukagjinit. Partia e këtyre pjesmarrësve ishte Dukagjini. Gjatë

grupi u zgjoll Gjan Kosteri, Gjon Dukgilaj dhe Pllumb Vrinca, anëtar.

Përfituesit e asfaltimit të rrugës janë banorët e kesaj krahinë, janë vizitorët vendas, dhe të huaj që kanë shfaqur interes për ta vizituar këtë zonë, që numri i tyre pritet të shumëfishohet nëse rruga do të asfaltohej. Qeveria shqiptare duhet të përpiqet që të shfrytëzojë resurset që kjo krahinë për të rritur mirëqenien kombëtare. Atje ka masive me gështenja, me rreth 2000 hektarë vetëm në zonën

e Pultit, por që ka të tilla edhe në Shosh dhe Shalë.

Një pasuri e madhe vjen nga shfrytëzimi i turizmit në këtë zonë. Nëse rruga Qafë T'hore –Theth bllokohet nga bora për një kohë të gjatë, krahu tjetër Prekal-Breg Lumi mund të mirëmbahet nga reshjet e borës me ndonjë mjet pastrimi bore. Kjo sjell turizem gjithëvjetor. Janë te shumta kanionet, ujvarat, shpellat, etj qe terheqin kërshërinë e vizitoreve e kështu do të rriteshin të ardhurat e banoreve në këtë zonë, por edhe kombëtare.

Një punë e tillë do të bënte të mundur ripopullimin e zonës, që është domosdoshmëri.

Janë një grup i konsiderueshëm që janë të punësuar në mirëmbajtjen e kesaj rrugë, por kur ushton nga Shkodra për në këtë Krahinë asnjë nuk duket, asnjë gurë i heqar, deri edhe mbi asfaltin e ri në Qëftë të T'hores nuk është vënë dorë fare për pastrimin e gurëve, madje edhe puna e kryer për pastrimin e borës me mjete ka bërë që nga pakujdesia të dëmtohen panelet mbrojtëse që janë aq të domosdoshme për këtë rrugë në terrene shumë të thyera.

Veprimtaria “Te gjithë bashkë për rrugën e Dukagjinit”, kërkon të bashkojë çdo biznesmen

dhe me shumë rëndësi ishin të pranishëm edhe Nënkrystari i Bashkisë Shkodër Ben Gjura, dhe sekretari i Këshillit të Qarkut Shkodër Gjon Marku. Këta vlerësuan edhe përshëndetën këtë tubim, por edhe premtuan që të bëjnë më të mirën e mundshme për këtë rrugë.

Për të drejtuar këtë veprimtari mbledha vendosi që të ngrihet një grup punë që do të merrë me organizimin e punës për sensibilizimin e komunitetit por veçnaërisht të hallkave shtetërore i përbërë nga 9 persona. Kryetar i tij u zgjoll Petrit Arra, nënkryetar Gjon Shkambi dhe sekretar Tom Ndoka, Agron Hasanaj, Ndue Ftoni, Prele Shytani, Ndue Marashi, Mhill Prroni, dhe Gjovalin Kodra, anëtar.

Po kështu u zgjoll edhe një grup pune i përbërë nga 3 veta, për kontrollin e përdorimit të fondeve monetare që do të mblidhen, me qëllim që të dihet se si u shpenzuan e ku shkuan. Kryetar i këtij

apo banor të Dukagjinit që të ndihmojë për asfaltimin e 76 km rrugë automobilistike, për të kontribuar kështu për të ardhmen e tyre. Nëse së bashku do mund të arrijmë 20% të fondit të përgjithshëm që duhet për asfaltimin e rrugës, atëherë pritet edhe mbështetja e Qeverisë shqiptare dhe e Fondit të Zhvillimit Shqiptar, për realizimin e kësaj ëndrre të madhe për çdo dukagjinan.

Për çdo kontribues do të funksionojë një numër llogarie bankare të shpallur publikisht në media dhe cdo kontribut do të pajiset me dokumentin përkatës si dhe shpalljen publike të kontributit, pavarësisht sasisë së derdhur (sasia do të lihet sipas dëshires së personit dhe mundesive që ai ka). Çdo lek i investuar do të trajtohet me transparencë të plotë dhe të vazhdueshme, duke përjashtuar cdo mundesi abuzimi, ashtu sic mund të ketë ndodhur në ndonjë rast.

Është me vend të thuhet se kjo ishte një mbledhje dhe diskutim i jashtëzakonshëm për interes e Dukagjinit dhe dukagjinasve. Ishtë një diskutim shumë i hapur dhe shoqëror, që vlen të merret si shembull.

Kjo ishte një thirrje e hapur dhe konkrete e banorëve të Dukagjinit ndaj shtetit të tij. Dhe shteti duhet ti dëgjojë shtetasit e tij.

Urime dhe dalshim faqebardhë, ishte përshëndetja e të gjithëve në këtë tubim me shumë vlera.

Korespondenti i gazetës  
“DUKAGJINI”

# RRUGA E DUKAGJINIT FYTYRA E SHEMTUAR ANTIPOPULLORE E POLITIKES 25 VJEÇARE SHQIPTARE!

**SHKATËRRIMI DHE BRAKTISJA TOTALE DUKAGJINIT ËSHTË MARRJA E TE GJALLËVE TE SOTËM!**



Para një jave ka lindur një iniciativë e re e komunitetit Dukagjinas për asfaltimin e rrugës Prekal – Breg Lumi e katandisur në një gjendje, mjerane mizerabële dhe vdekjeprurëse për zemrën e Alpeve shqiptare: Kam qene i ftuar por për arsye pune nuk isha pjesëmarrës në atë takim i cili me sa jam i informuar me tepër se një iniciativë vullnetare për mbledhjen një X apo Y shume nga xhepat e shtjerrur te këtij komuniteti ishte një indicje për gjetjen e një donacioni serioz për çlirimin e kësaj krahine nga makthi i tmerrshëm i këtij ferri izolues shume shekullor. Nuk është rasti i pare i një nisme te tille, pasi para disa vitesh ka patur një nisme nga Bal Vuksani ku edhe u krijua një shoqate. Dje, sot, mot dhe deri sa te zgjidhjet kjo “Nyje Gordiane” që mban te lidhur për fyti Dukagjinin jam ne vijën e pare te këtij fronti jo vetëm me mendje e zemër por edhe financiarisht sa ka vixhutin një buxhetori i rangut te mesëm te shtetit me fukara te Evropës. Sa hidhet një ide, akoma pa u artikulluar qarte fillon opopenca, dyshimet, supozimet xhelozitë dhe ankesat vajtuese Perceptimi kolektiv është se me lehte kalohet ylberi e vajza behet djalë se mund te hapet kjo rruge e namur nga Perënditë dhe shenjtoret tanë te politikës.

Kjo rruge ne kohen e Partisë se Punës dihet se u hap me pune vullnetare te detyruar, jashtë çdo mundësie teknike qe kishe kjo zone, u hap me kazmë lopate quski dhe maj. U hap pa një projekt te mirëfillte inxhinjerik por sipas dilitantëve politik. Drumi i ri që i pa pare deri atëherë ne ato male pati dhe viktima njerëzore gjate ndërtimit, por gjithsesi u be brenda një kohe rekord pasi fjala e partisë si mire si keq ishte ligje. Vetëm pasi ndërtua Ramiz Alia ditën e inaugurimit tha -Ju lumtë, por Partia dhe pushteti nuk kane patur nevojë për gjithë këtë pune vullnetare! Shokun Ramiz nuk dha as një dekorate as fletë lavdërimi për iniciatorët e kësaj angarie kolosale. Shoku Ramiz ngjiti larte e me lart shkallet e karrierës politike, ndërsa ai nuk erdhi me kurrë me ne Kirë, as nuk u kujtua kurrë qe ketë rruge te shqyer me thonj nga argatë e ushqyere me buke misri e turshi(paterxhana) ta sillte ne standardet e një rruge me standarde normale. Shoku Ramiz dhe mërgata e tij e qyqve kaluan ne heshtje mecece edhe tragjedine e tmerrshme te vitit

1985 ku gjeten vdekjen 35 veta dhe po kaq u plagosen. Pas fundit te pa lavdi te Sistemit Totalitare kjo rruge mori akoma ma tepër te teposhtën duke u shndërruar ne një shtrige qorre, gjarpërushë frikshme gjakatare e lare me gjak dhe e mallkuar me jetën afro 100 viktimave. Dukagjini duke i besuar sinqeritetit te tij, naivitetit te tij minor, ra prehe e lajkave, mashtrimeve dhe intrigave imorale dhe vakabandazhit politik duke u ç'burrëruar e vrarë veten politikisht ne mënyrën më dhimbshme. Kam shkelë me këmbë dhe pa me sytë e mi kohet fundit te gjitha trevat veriore Shqipërisë. As kund nuk ka mrekulli te bëra nga dora e njeriut te ri socialist as demokrat, por askund nuk te sheh syri rruge me skandaloze

hidrike me shume se Shala, Shoshi apo Pulti?! Cila nga këto Njësi Administrative aktualisht ka pasuri pyjore me shume se Shala, Shoshi Pulti, apo Shllaku?! (Nëse deri dje kishin me shume pyje ato sot nuk janë me se ato i prenë dhe dogjën pasivisht). Këto “mrekulli” pukjanëve u ka siguruar përfaqësimi politik ne qeverisjet e tona që dihet si kanë qene. Urtësia popullore na kujton; -Kush i rri dardhës pranë nuk mbetet pa gjë send! Kur nuk je ne kuvend pleqin ta bëjnë te tjerët si te duan! Ne nuk patëm mend te përfaqësohemi dhe mbetëm bythëjashtë! Ne u falim te tjerëve nga 2-3 mandate dhe vetë rrimë e presim si sharovi pas hajatit se kush do na hell një mys buke. Tani qe mbetem me bark pete dhe gjithë

qindra vjeçare te kullave te malësisë

- Nga mungesa e kësaj rruge te asfaltuar nuk ka mbetur shkolle funksionale, as këmbë mësuesi as nxënësi mirëfillte.

- Nga mungesa e kësaj rruge te asfaltuar kane mbetur te gjitha arrat djerr livadhet e mrizet pa tufa bashtinat e ograjat, rrahijet e shpatinat janë mbuluar nga kanabisi prej te cilit bosët e metropoleve vjelin mishin qumështin e përsheshin ndërsa fukarenjtë leshin.

- Nga mungesa e kësaj rruge te asfaltuar varret kanë mbetur ne vetmi e gjithë Dukagjini shkretirë. Shkatërrimi dhe braktisja totale është marrja e te gjallëve te sotëm te Dukagjinit! Nuk besoj se kemi zënë mend ne politike as politika nuk ka besë as moral. E pa çfarë duhet



dhe me gjendje me tmerrshme se rruga e Dukagjinit. Te marrim një krahasim te thjeshte pa shkuar larg dhe ne kushte natyrore te përafërta. Te gjitha ish komunat Pukës kane rruge te asfaltuar (Iballa, Fjerza, Blerimi, Qelëza, Qaf Mali, Gjegjani) E fundit qe është asfaltuar është rruga Iballës 40 km larg nga Fushe Arrëzi sa rruga Prekal Breg Lumi Ju lumtë dhe gëzofshin! Kush është i zoti mos i shokftë i zi moti! Cila nga këto Njësi Administrative ka me resurse sa Thethi apo Dukagjini si zinxhir eko-turistik?! Cila nga këto Njësi Administrative aktualisht ka popullsi me shume se Shala apo Pulti?! Cila nga këto Njësi Administrative aktualisht ka pasuri

na futen, lehim si qeni ne hanë duke pritur mrekullitë nga qelli ose mashtruesit e radhës. Dukagjini kishte dhe ka djem qe po të kishin karton e përfaqësimi do ta kishin bere me kohe dhe mund ta bëjnë përsëri ketë rrugë. Te jesh i papërfaqësuar ne as një nivel është skllavëri moderne! Të mos jesh në gjendje te vetëpërfaqësohesh është vetëvrasje. Kush vret vetin vetëm dreqi ja merr gjakun!


- Rruga e Dukagjinit është fytyra e shëmtuar antipopullore e politikës 25 vjeçare shqiptare.

Nga mungesa e kësaj rruge te asfaltuar ka ndodhur gjithë ai migracion biblika sa kanë mbirë ferrat në shumicën e vatrave

bere atëherë?! Tani duhet t'i thërrasim virtytit me vital, bujarisë që na bën krahinën me shembullore shqipfolëse. Do pune duhen bere o mend o me takat. Përdërisa nuk kemi mend duhet te heqim diçka nga kafshata jonë dhe te kontribuojmë sa te bëhemi te besueshëm për ndonjë fondacion. Nëse baballarët tanë ketë rruge e hapen me kazmë dhe paterxhana te regjur. Ne për hire te varreve të tyre te mbuluar nga fieri dhe serushkat duhet ta asfaltojmë me krahët tanë ose t'i imponohemi këtij shteti duke i kujtuar se Dukagjini është Shqipëri!

**PRELE MILANI**

# 100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin



**SHOQATA "ATDHETARE-DUKAGJINI"**  
Vendim nr. 666, date 13 maj 2003  
Lagja "VOJO KUSHI", rruga "ÇLIRIMI", pallati 1261, Shkodër, tel: 00355 222 43664,  
mob: 00355 692328116, adresa: www.shoqatadukagjini.com, e-mail: nduesanaj@yahoo.it

---

Nr. 1255 prot. Shkodër, me 27 / 05 / 2016

**VENDIM**  
Nr 212 date 23 / 05 / 2016

**PËR KRIJIMIN E GRUPIT TË PUNËS, QË DO TË REALIZOJË  
STUDIMIN E ARSIMIT 100 VJEÇARE, NË DUKAGJIN**


Kryesia Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", sot me datën 23 maj 2016, pasi diskutoj propozimin e bere nga Sekretari i Shoqatës, Luigj Shyti, për studimin e arsimit 100 vjeçar në Dukagjin, dhe ngritjen e grupit të punës për këtë qelim;

**VENDOSI:**

- 1-Të ndërmarrë një studim për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës në Dukagjin, në kuadrin e 100 vjetorit të hapjes së Shkollës së Parë, me temë: "100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin"
- 2-Grupi i punës, për organizimin e këtij studimi, të përbëhet:
 

|                       |            |
|-----------------------|------------|
| 1- Luigj Shyti,       | Kryetari   |
| 2- Prelë Shytani      | N/Kryetari |
| 3- Aleks Dushi        | sekretar   |
| 4- Syka Carku         | anëtar     |
| 5- Kolë Cardaku       | anëtar     |
| 6- Lazër Kodra        | anëtar     |
| 7- Gjovalin Kodra     | anëtar     |
| 8- Tereze Brigja      | anëtar     |
| 9- Ndoc Zef Prendushi | anëtar     |
| 10- Kin Kola          | anëtar     |
| 11- Zef Toka          | anëtar     |
- 3-Grupi i punës, brenda datës 10 qershor të parqesë programin i punës dhe n/grupet që do të punojnë, për realizimin e këtij studimi.
- 4-Studimi të përfundojë deri në muajin maj 2017. Pas përfundimit të studimit, brenda muajit tetor 2017, të organizohet konferenca shkencore dhe, me studimet e paraqitura, e materiale të tjera për arsimin dhe kulturën, të botohet një libër i veçantë.
- 5-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet grupi i punës.
- 6-Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.

**NDUE SANAJ  
KRYETARI**



## PLATFORMË STUDIMI

Në vitin 2017 mbushën 100 vjet nga fillimi i arsimit në Dukagjin. Shoqata "Atdhetare Dukagjini" ka ndërmarrë një studim që është me shumë rëndësi për Dukagjinin me temë: "100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin".

Jeni i përzgjedhur për të na ndihmuar me njohurit tuaja në lidhje në këtë studim, prandaj po ju paraqesim këtë platformë studimi ku mund të jepni mendimet tuaja. Do të ishte mirë që të jepnit mendimet tuaja për të gjitha pyetjet, por kjo do të jenë sipas dëshirës dhe mundësisë tuaj.

1- Kur u hap shkolla për herë të parë fillore, 7-8-9 vjeçare dhe e mesmja, sipas njohurive tuaja në fshatin, apo zonën ku keni punuar ju, ose ku banoni, apo që keni njohuri ju.

2- Shkruani të gjithë mësuesit (me emërim të përhershëm, apo të përkohshëm) që i kujtoni që kanë punuar në fshatin tuaj, në shkollën ku keni punuar, pavarësisht në se janë vendas apo nga zona jashtë Dukagjinit, duke cilësuar edhe shkollën ku kanë punuar.

3- Sa nxënës kanë qenë në kohën më të mirë që kujtoni ju duke i ndarë në femra dhe meshkuj. Sa ka qenë në këtë kohë numri i popullsisë sipas fshatra ku keni punuar, banoni ju, apo keni informacion.

4- Është domosdoshmëri mbledhja dhe përpunimi i të dhënave statistikore për shkollat, gjë të cilën më shumë mundësi mund të kenë drejtuesit dhe ish drejtuesit e shkollave.

5- Foto të ndryshme nga shkollat dhe veprimtaritë e tyre.

6- Janë domosdoshmëri fotot e ndërtesave shkollore dhe drejtuesëve të shkollave.

7- Veçoni të gjithë emrat e drejtuesëve të shkollave që ju kujtohen në fshatin tuaj, apo shkollat ku keni punuar duke specifikuar shkollën përkatëse.

8- Shënioni ata që janë marrë me kulturën duke specifikuar si drejtues, apo si pjestarë të grupeve artistike dhe punën me librin.

Shënioni vatrat dhe shtëpitë e kulturës që kujtonin të gjithë krahinën.

9- Shënioni bibliotekat në shkollë apo fshat, libraritë, dhe kur filluan veprimtarinë e tyre. Kush ishin drejtuesit e tyre. Po të mundeni vendosni një numër sa më të saktë të librave në bibliotekat e shtëpive dhe të vatrave të kulturës që keni njohuri ju.

10- A keni njohuri për bibliotekat, ose këndin e librit në familjet e fshatit ku jetoni ose keni punuar. A mund të shënioni numrin e tyre dhe sasinë e librave në to.

11- Janë shumë të vlefshme shënimi i mendimeve, në këtë rast, veçanërisht në drejtim të arsimit dhe të kulturës. arrijtjet sipas vlerësimit tuaj, dobësitë që janë vretur, akte të veçanta, puna që është bërë në të gjitha kohrat, që kanë vlerë për lexuesin, për historinë dhe brezat e ardhshëm, nisimat që janë ndërmarrë nga shkollat dhe mësuesit, vlerësimet që janë dhënë shkollave nga autoritetet shtetërore të kohës, e të tjera.

12-Të nxiten të gjithë ishmësuesit, ish drejtorët dhe të gjithë ata që janë aktiv sot për të shkruar kujtime nga jeta në punën e tyre në Dukagjin, pasi do të mblidhen, redaktohen dhe përgatiten për një botim përmbledhës.

13-Shkruani çfarë mund të dini për luftën kundër analfabetizmit në vitet e para pas çlirimit, dhe më vonë, shtëpitë ku zhvilloheshin kurset, drejtuesit e kurseve, kushtet e kursit, niveli i përvetësimit, etj, për të cilat mund të keni njohuri ju

14-Grumbullimi i materialeve të bëhet në njërin nga këto adresa elektronike:

njeqindvjetarsimnedukagjin@hotmail.com; nduesanaj@yahoo.it; luigjshyti@yahoo.it. Në raste të veçanta edhe dorazi.

15- Ftojme të gjitha ata që kanë njohuri dhe mundësi bashkëpunimi për këtë problem. Jemi në pritje të këtij bashkëpunimi.

**Me shumë respekt.**

**Kryesia e Shoqatës "Atdhetare Dukagjini"**  
**Grupi i punës për këtë studim, 10.6.2016**

## Zhvillohen zgjedhjet në Shoqatën "Dukagjini" në Mchigan

Me datën 1 maj 2016, Shoqata "Dukagjini", në Miçigan ka bere analizën vjetore dhe zgjedhjet në Shoqate. Në këto zgjedhje:



Arben Sokoli, nga fshati Lekaj-Shale, është zgjedhur Kryetari i Shoqatës



Prel Marku, nga fshati Plan-Pult, është zgjedhur N/Kryetari i Shoqatës



Jetmir Dedaj, nga fshati Toplan, është zgjedhur Sekretari i Shoqatës

Redaksia e gazetës "Dukagjini", ju uron me faqe të bardhe në detyrat fisnike, në drejtimin e kësaj shoqate, që përfaqëson bashkësinë dukagjinase në Miçigan.  
**Korrespondenti "Dukagjini"**

## Paraqitet libri “Dhuratë dhe angazhim..”

Me datën 18 qershor 2016, ne orën 11. 00, Arqipeshkvia Metropolitane-Shkodër-Pult, në sallën “Mikel Koliqi”, organizoi ceremoninë e paraqitjes së librit “Dhurate dhe angazhim”, pas stuhisë komuniste.


Në këtë ceremoni morën pjesë intelektual, veprimtar në qytetin e Shkodrës dhe autoritete të pushtetit vendor, si: Kryetari I Këshillit të Bashksë Shkodër, Xhemal Bushati; N/Kryetari I Këshillit të Qarkut Shkodër, Maxhid Cungu, Ish Kryetari I Bashksë Shkodër, Lorenc Luka e të tjerë. Nga Shoqata “Atdhetare-Dukagjini” morën pjesë, kryetari I saj, Ndue Sanaj, sekretari I saj, Luigj Shyti, dhe anëtarët Roza Pjetri e Ndue Mici.

Ceremoninë e hapi Sekretari I Komisionit për Drejtësi e Paqe, Luigj Mila.

Dhanë opinione profesor dr. Arben Prendi, profesorësh Netila Haxhija-Ljarja dhe Drejtori I Bibliotekës “Marin Barleti”, Gjovalin Çuni.

Në fund pwrshwndeti edhe Imzot Angelo Massafra.

Korespondenti “Dukagjini”



## “Homeland” Zeng Yi, vjen në Tiranë

Gjin Musa, gazetar, Romë

Tirana dhe Muzeu Historik Kombëtar do të jenë stacioni i radhës për të mirëpritur ekspozitën ndërkombëtare “Homeland” e sjellë nga fotografi i mirënjohur kinez Zeng Yi. Kjo ekspozitë vjen në Shqipëri për herë të parë dhe gjithashtu është hera e parë që një artist kinez hap një ekspozitë personale në Muzeun Historik Kombëtar, duke u mbështetur nga Bashkia e Tiranës, Bashkia Pietrasanta në Itali dhe Ambasada e Republikës Popullore të Kinës. “Homeland” sjell për publikun shqiptar 40 foto bardh e zi e disa me ngjyra, të jetës së përditshme të njerezve të moshuar kinezë, që jetojnë në provinca të Kinës.

Ideja për të sjellë këtë ekspozitë në Shqipëri ishte një shkrirje dëshire mes artistit shqiptar Alfred Mirash Miloti, i cili është edhe kurator i kësaj ekspozite dhe fotografit Zeng Yi. Drejtorit të Muzeut Historik Kombëtar, z. Melsi Labi, sapo i është shprehur kjo ide ka thënë se: “Që në fillim kur artisti i mirënjohur shqiptar z. Alfred Mirashi, Milot më ofroi idenë për të pritur në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar fotografitë unike të mjeshtër Zeng Yi, menjëherë më mbuluan ndjenja të tilla si dëshira dhe nderi për të sjellë sa më parë në muze veprat e këtij artisti të madh. Vetëm mendojeni pak se sa bukur do të shkrihen në një të vetme historia, kultura dhe traditat kineze-shqiptare. Magjia që karakterizon çdo një nga hapësirat e muzeut do të mbulohet nga një magjepsje akoma më e madhe prej fotove dhe fytyra plot jetë të njerezve të thjeshtë, duke na treguar çdo emocion dhe ndjenjë të thellë vetëm nga

drita në sytë e tyre”.

Falë eksperiencës së tij, Zeng Yi gëzon një reputacion vlerësues si një nga fotografët kinez më të njohur botërisht dhe ka mbështetjen e lartë të Këshillit Shtetëror



të Kinës. Aktualisht ai mban disa poste të ndryshme drejtuese si, profesor dhe udhëheqës doktoraturash në Universitetin e Arteve dhe Dizanjit në Shandong, kurator nderi i Muzeut të Artit në Shandong, president i Mo Zi (Instituti Ndërkombëtar Kërkimor i Imazheve) anëtar i komitetit kuratorial të Shoqatës së Fotografëve Kinezë dhe President i Shoqatës Ndërkombëtare të Fotografëve të Lindjes.

Punimet e tij janë koleksionuar nga shumë muze dhe galeri në të gjithë botën. Vetë Kryebashkiaku z. Erion Veliaj, është shprehur se: “Një botë krejt origjinale vjen nëpërmjet stampimit të një ças-

ti të vetëm. Dhe këtë mund ta bëjë më mirë se kushdo tjetër një fotograf si Zeng Yi. Ky talent mjaft i njohur në artin e fotografimit, pasi ka shëtitur në mjaft shtete të botës, mbërrin me një ekspozitë personale edhe në Shqipëri”.

Që prej vitit 1980, Zeng Yi ka realizuar ekspozita të shumta fotografike, leksione dhe veprimtari akademike në shtete të ndryshme, duke përmendur këtu Amerikën, Belgjikën, Maltën, Qipron, Gjermaninë dhe Italinë.

Z. Massimo Mallegni, i cili është kryetar i Bashkisë Pietrasanta në Luca, Itali, do ta mirëpresë këtë ekspozitë në bashkinë e tij pasi mjeshtri Zeng Yi të përfundojë promovimin e tij në Shqipëri. I pyetur për fotografimin Zeng Yi, Kryebashkiaku Mallegni është shprehur: “Kontributi i tij merr një rëndësi themelore si provë jo vetëm e ndjeshmërisë së lartë dhe afësisë, por edhe si dokumentim i transformimit të ri dhe të vazhdueshëm të shoqërisë bashkëkohore kineze, në zhdukjen pothuajse të menjëhershme të një bote rurale, e përbërë prej traditave të lashta, zanateve mjeshtërore dhe fytyrave të çiltra, nganjëherë të mbushura me rrudha të thella”.

Mjeshtri Zeng Yi ka fituar çmime të ndryshme prestigjioze kombëtare dhe ndërkombëtare si, “Qendra Kulturore e Azisë” nga UNESCO, çmimi “Ros International Photography për Kontribut

të jashtëzakonshëm” dhe çmimin “Sungkyunkëan Art”. Së fundmi ai ka qenë i ftuar për të hapur një ekspozitë personale tek Biblioteka Presidenciale Xhimi Karter dhe Muzeu i Atlantës, në tetor 2015. Ishin të gjitha këto arsye që nxitën artistin e talentuar shqiptar dhe kuratorin e kësaj ekspozitë z. Alfred Mirash Miloti t’i sugjeronte dhe ofronte mjeshtër Zeng Yi të çelte një ekspozitë në Muzeun Historik Kombëtar, si përçuesi më i mirë e historisë dhe kulturës shqiptare.

Ja si e sjell në mendje të gjithë këtë ide z. Miloti: “Në këtë moment të suksesit të tij të madh artistik dhe pas ekspozitës së tij personale në Neë York në Fondacionin Jim Carter, para disa ditësh ne St. James Cavalier ne Valleta ne Malta ishte i ftuar Zeng Yi si një nder me personazhet me famose ne boten e fotografise sjell veprat e tij të artit, fotografitë e tij, në muzeun më të madh të Shqipërisë dhe Ballkanit. Është hera e parë në historinë e Shqipërisë, që një artist kinez hap ekspozitë personale në Shqipëri. Në takimin tim të parë me z.Zeng Yi në Pekin e pyeta nëse do t’i pëlqente ideja për të ekspozuar veprat e tij në vendin tim të lindjes, në Shqipëri, duke theksuar se kohë më parë Shqipëria ishte një vend shumë i afërt me Kinën. Ai, pa e menduar dy herë më tha: “Po, të ekspozoj në Shqipëri, një mik i vendit dhe popullit tim, është dëshira ime më e madhe”.

Publiku shqiptar do të ketë mundësinë të shoh magjinë e këtyre fotove nga data 22 Maj-22 Qershor 2016, në sallën e ekspozitave në Muzeun Historik Kombëtar. Mirësevjen në Tiranë mjeshtër Zeng Yi!

# Objekte të G. C. Scanderbeg në Paris!

Në korrikun që sapo kaloi kisha planifikuar dhe vajta për vizitë në Paris, megaqytetin që nuk e kisha vizituar prej vendimesh të shtyra herë pas here. Ashtu si çdo vizitor i këtij qyteti, edhe për arsye të kohës së shkurtër, u përpoqa të përqendrohem në vizitën e objekteve më të rëndësishme dhe më të arritshme prej aty ku banoja.

Si një ish ushtarak nuk mund të lija pa vizituar edhe "Muzeun e Invalidëve" ose siç e quajnë vendësit "Muzeu i Ushtrisë" ("Musée de l'Armée"), një institucion madhështor për nga bukuria, gjigant për nga përmasat dhe me një pasuri maramendëse eksponatesh ushtarake por edhe dokumentare. Pasi kalova sallat me radhë, u gjenda në një të tillë ku paraqiteshin materiale ushtarake mesjetare, kryesisht armatura për njerëz e kuaj, të një shumëllojshmërie, saktësie dhe estetike të pazakontë.

Ndërsa kaloja stendat ndalova para një mburoje, tek e cila shqiponja dykrenore, që nuk mund të mos i tërheqë vëmendjen çdo shqiptari, ishte vizatuar mbi basorelievin me të njëjtën figurë, gati me përmasat e mburojës, e stërmadhe; kurse vetë mburoja mbartte një të kuqëremtë ku dallohej qartë që ngjyrat, edhe e kuaja edhe e zeza, kishin dalë boje.



Ishte mburojë druri e punuar bukur, me shqiponjën e zezë në sfond të kuq. Ishte E JONA. Shtanga. "Punim gjerman, i rreth 1450 (?), jashtëzakonisht i rrallë, prej druri, pikturuar me shqiponjën bicefale etj." shënohej për të në skedë.

Duke se korrupimi i ngjyrës origjinale kishte ndodhur në të kaluarën për shkak të magazinimit në kushte të këqija. Dy si grremça në pjesën e sipërme, që mund të kenë qenë aty prej fillimit ose t'i jenë vendosur më vonë për ruajtje a për ta varur në mur, ishin e vetmja gjë metalike që shihej në të ballas.



E dija, si shumica e shqiptarëve, se shqiponja dykrenore ishte simboli më i dukshëm në emblemën e Familjes së Kastriotëve; dija gjithashtu që ishte Konica i madh ai që e vuri në dukje i pari këtë fakt

për ta risjellë në vëmendjen e rilindësve, çka u bë shkak të vendosjes e të bëhej përjetësisht simbol i shqiptarëve kudo në botë. Por se do ta shihja me sytë e mi, drejtpërdrejt, një objekt për të cilin u binda njëherazi që vetë Heroi ynë e ka patur në dorë, këtë nuk ma kishte marrë mendja dhe më pushtuan emocionet.

U rrotullova nga të gjitha anët, por në atë të pasme (e brendshme) të mburojës nuk shihej gjë për shkak të ndriçimit të pakët, ndërsa në profil u ndesha me një çudi tjetër. Pa asnjë përjashtim, çdo mburojë që kam parë është e mysët, larg mbajtësit, ndërsa kjo kishte përkulje të kundërt, ishte e luguë.

M'u duk gjeniale si gjetje, sepse për një kalorës ajo mburojë prej druri shumë të fortë dhe njëkohësisht të lehtë, krahasuar me mburojat e mbushura me pafta hekuri e fletë llamarine, me formën e saj konkave, pra përkulur nga jashtë e theksuar në pjesën e poshtme, lejonte lëvizshmëri e lirshmëri, si kaluar ashtu edhe në këmbë, pa dëmtuar kofshët a gjunjët e luftëtarit. Kishte edhe një si zgavër në pjesën e sipërme djathtas, ndoshta për të siguruar shikim përmes saj në kushtet e mbrojtjes nga goditjet e afërta apo të largëta (shigjeta) ose për të vendosur në të ushtën, si në rastet e dyluftimeve që aq shumë i kemi parë nëpër filmat e Hollywood-it. Fotografova.

\*\*\*

Jam i sigurt se gjëja e parë që i shkon ndër mend skeptikëve dhe nihilistëve është se shqiponja dykrenore është gjithashtu simbol i sllavëve dhe i gjermanikëve. Por, përpos faktit që këtë muzeum e ka vizituar si njëra palë edhe tjetra dhe nuk kanë kurrfarë pretendimi, përpos faktit se këtë dyshim dhe mosbesim nuk e shprehin as specialistët francezë me kulturë tradicionale në këtë fushë - konservues të objektit në atë muzeum, përgjigjja vjen nga vetë historia e shfaqjes së shqiponjës në hapsirën ballkanike: është ku e ku parasllave e parabizantine, për më tepër edhe në Bizant ajo është prezantuar prej Kostandinit të Madh, njëgjakësit tonë prej Shkupi, duke na vënë përsëri në origjin të saj. Por nuk mbaron këtu, shqiponja jonë dykrenore e periudhës mesjetare, ndryshe nga të tjerat gjithfarë ngjyrash, është e zezë dhe në dallim me gjermaniket shpaloset në sfond të kuq. Thënë këtë, nuk besoj se ngjyrat janë rastësore dhe aq më pak në një mburojë, kur dimë që përgjithësisht

ato kanë ngjyrën e materialit me të cilin janë bërë; mendoj se mesazhi që përcjell mbajtësi i saj është i njëjtë me atë të flamurëve, pra ngushtësisht identitet. Sjell në vëmendje se flamurë të ndry-

shëm: shtetesh, institucionesh publike a private, skuadrash sportive a qytetesh etj., nuk mund t'i ngatërrojmë me njëri tjetrin kurrsesi dhe kjo jo vetëm prej elementëve figurativë por edhe larmisë së ngjyrave.

Si për të ilustruar se Scanderbeg ka patur mburojë me shqiponjë të zezë në të, po sjell këtë gravurë të punuar në vitin 1717, ku Scanderbeg paraqitet me armatimin e tij. Dallohet qartë mburoja me shqiponjën dykrenore, pikturuar me përmasat e mburojës, njëlloj si mburoja që gjendet në Paris.



Gravurë e shek. XVIII

Në këtë gravurë shihet qartë sesa i familjarizuar ka qenë piktori me pamjen e shqiponjës bicefale, teksa i ka pikturuar qafat në mënyrë të panatyrshme; kuptohet se jo vetëm nuk ka patur mburojën e Scanderbegut përpara kavaletit, por as nuk ka parë me sy një symbol të tillë në kohën e vet. Ajo duket naive në vetvete, gati e pabesueshme, aq sa kurrkujt nuk do t'i shkonte ndërmend se për cilin personazh bëhej fjalë po të mos kishte kushtimin e qartë me shkrim poshtë saj me emrin e heroit. Meqenëse piktori ka jetuar shekuj më vonë, vetëkuptohet që për ta realizuar gravurën të jetë bazuar në ndonjë përshkrim të hollësishëm të armatimit, pra në një material dokumentar historik që ndoshta ende sot gjendet i fshehur në ndonjë arkivë.

Aq dyshues kemi qenë me këtë gravurë sa, duke e konsideruar si pjellë të fantazisë së artistit, nuk e kemi promovuar publikisht, por thjesht cilësuar si një vepër arti kushtuar heroit. Ajo do të vazhdonte të trajtohej si e tillë nëse sot nuk do të kishim në Muzeun e Ushtrisë në Paris një mburojë të dekoruar me shqiponjën bicefale, në të njëjtat raporte përmasash.

Shpresoj që, sado të paepur të jenë, këta zëra të meken a të shuhen fare kur të ballafaqohen me objektet në fjalë, mburojën me gravurën.

Edhe më e besueshme bëhet dëshmia përmes gravurës nëse ndalemi tek pajimet e luftëtarit, një një thumb te armatura, në gju. Nëpër muzeume përipiqesha më kot të gjeja një të tillë në armaturat njerëzore, ndaj e konsideroj veten me fat kur më në fund hasa në një ekzemplar të vetëm armature, siç shihet në foton që bëra në Kështjellën (Muraio) të qytetit Avila në Spanjë.

Teza e fantazisë së "shfrenuar" bie përfundimisht për t'i lënë vend habitës në saktësinë e artistit ndërsa na i sjell në këtë formë gati didaktike armaturën dhe pajimet luftarake të Scanderbegut, për më tepër me shënimin se kjo i kushtohet saktësisht atij dhe jo tjetërkujt. Besoj se nuk ka më vend për komente.

Elementë të tjerë, që nuk mund t'i shpëtojnë syrit, janë palat e hekurta të "fundit" të luftëtarit; ndryshe nga të zakonshmet, drejtkëndore ose të thurura, këto të gravurës janë në formë gjetshesh të mëdha, të njëja si edhe në armaturë. Duhet të shtojmë këtu elementin "pendë" në kapelën e Scanderbegut në gravurë, që është i njëllojtë me pendën që gjendet në kapelën e heroit në një skulpturë të realizuar në të gjallë të tij (1444) dhe që na vjen e "ruajtur" në një gravurë tjetër si dhe në një gdhendje ndryshe, kushtuar atij, për vitin e të cilit nuk dimë gjë.

Kam bindjen se mburoja me shqiponjën e zezë në sfond të kuq, që gjendet në muzeun parisien dhe gravura e Scanderbegut, vijnë si ato binomet polimerike që përforcojnë lëndën: Po, kjo mburojë i përkiste G. C. Scanderbegut.

Si për të hequr çdo dyshim, ja dhe fotot ballafaqese:



Thumbi në gjurin e armaturës ushtarake (gravura kushtuar Scanderbeg) majtas, thumb në armaturën djathtas.

(Të katër gravurat janë marrë në facebook nga publikimet e z. Kreol Bajo)

Dëshmohej pra se Scanderbeg na shfaqet jo vetëm një herë me kapelë me pendë; përveç gravurës së shek. XVIII, kemi një tjetër të mëparshme, madje edhe në të gjallë të heroit ka patur një skulpturë ku ai shfaqet me të njëtin mod-



1. Scanderbeg me kapelë me pendë; 2. Sunduesi i Larisës;  
3. Skulptura në gravurë.

el kapeleje (ndërsa skulptura ka humbur, tashmë gjendet vetëm piktura e saj). Qëllimisht vura edhe portretin e mbretit të Larisës, për të dëshmuar se kultura e veshjes me kapelë me pendë nuk është aspak e huaj ndër prijësit tanë prej një gjaku.

Na mbeten të pasqaruar dy elementë: së pari, që skeda cilëson "Punim gjerman" dhe besoj se është përshkruar ashtu ngaqë shqiponja dykrenore u ka ardhur e panjohur (sidomos për periudhën), ndërkohë që shqiptarët e kanë "gjenezikë" dhe së dyti, që shkruhet 1450 (?) pa thënë se viti është ai punimit apo është gjetur mburoja. Secili rast, që flet vetë, provon se kemi të bëjmë me një cilësim të nxjerrë sipas gjasës dhe jo të thëlluar mjaftueshëm.

\*\*\*

Më duhej të lëvizja edhe për arsye kohe, por befasisht nuk kishin të sosur, bile më të mëdha se e para. Disa metra më tutje, në të njëjtën sallë, në një stendë të mbyllur me xham, në mes të disa armaturave ushtarake shquhej një parzmorë e lehtë kali me shalën dhe një cohë të kuqe dalë boje. Ishte e verdhë, prej bronzi, por ... edhe kjo kishte të stampuar në ballë të kalit si dhe në "veshëzat" anash, shqiponjën dykrenore; e gjithë parzmorja e mbushur me zburime ndërsa shqiponja e punuar me mjeshtëri dhe saktësi të habitshme. Më e bukura që kam parë ndonjëherë.



Parzmorja dhe shala e kalit legjendar të Heroit? Më erdhën ndër mend njëherazi legjendat rreth tij, ndër të cilat njëra: besohet se në një shkëmb në afërsi të qytetit Krujë, ku ishte edhe kryekështjella, gjendet një vend ku ai kalë ka lënë gjurmë në shkëmb. Kështu quhet edhe sot: "Gjurmët e kalit të Skënderbeut".

Fotografova – "Parzmorë kali"

Skeda për të tregonte që ishte gjetur në jug të zonës gjermanike, rreth vitit 1555, që kishte ornamente orientale (Turkish stile) dhe me shënimin se i përkiste prijësit të kavalerisë ku bënte pjesë.

Gjithsesi edhe pse ishin në të njëjtën sallë, disa metra larg njëra tjetrës, nuk bëhej ndonjë lidhje mes saj dhe mburojës. Fakti që parzmorja mban ornamente orientale, turke, përjashton kategorikisht të jenë të një prijësi perëndimor, ndërsa kryqi i krishterë mbi heraldikën e parzmores përjashton në mënyrë të padiskutueshme që prijësi të ketë qenë turk apo i besimit musliman, ndërkohë vetë shqiponja e zezë dykrenore lidh parzmoren mesjetare me shtetin shqiptar të

kohës. Ajo që të tjerëve mund t'i duket një rebus i pazgjidhshëm për shqiptarët është krejt i thjeshtë, sepse nuk besoj se mund të gjendet figurë tjetër në atë epokë, veç Scanderbeg, që të mishërojë në një prijësin që pranon kulturën e Orientit, pjesë politike e së cilës Shqipëria kishte qenë për shkak të pushtimit të mëparshëm e ku ai vetë ishte formuar si ushtarak (për shkak se ishte marrë peng si shenjë nënshtrimi e të atit ndaj autoritetit të Portës së Lartë) dhe Perëndimit të krishterë në aleancë me të cilin ai luftonte Perandorinë Osmane (rreziku më i madh për Europën e krishterë në atë kohë) për çlirimin e vendit të tij. Kështu, nëse nga të dhënat që dalin, gjithkush tjetër përjashtohet për njërin apo tjetrën arsye, Scanderbegu përkundrazi, vetëm forcon pozitën si zotërues i këtyre objekteve.

Megjithatë mund të ngrihen zërat dyshues të thonë se tashmë nuk ke të kuqen ndërsa shqiponja e zezë nuk është domosdoshmërisht jona. Po, por kjo shqiponjë ka një heraldikë në qendër të saj dhe si e tillë njëjtësi bëhet shumë më i lehtë për shkak të dokumentacionit të pasur që gjendet botërisht në këtë fushë. Kurrkush deri tani në atë muze nuk ka dalë të thotë që kjo heraldikë ka këtë përkatësi, pra vjen nga ky shtet mesjetar.

Shqiponja e zezë dykrenore është e vetmja shenjë e "huazuar" nga simbolet e familjes Kastrioti, e natyrisht kjo sepse ai ishte prijësi i shqiptarëve nga Beslidhja e Lezhës; pjesa tjetër, në zëmër të saj, është Heraldika e Shtetit Shqiptar të udhëhequr prej tij, shtetit jetëshkurtër dhe me një kohë të errët pas, teksa pas një pushtimi gati pesëqindvjeçar humbi me gjithë shenjat e tij, për t'u rishfaqur befasisht pas 550 vitesh në këtë parzmorë.

Mbetet të analizojmë gjasat që kjo heraldikë të jetë e shtetit shqiptar.

Mendoj se po të ishte e tjetërkujt ajo, për arsyen e thjeshtë, do të kishte qenë njëjtësuar me kohë prej specialistëve, sepse nuk ka patur aq shumë shtete asokohe dhe se kujtdo prej figurave historike perëndimore apo lindore të asaj periudhe që do t'i përkiste do gjendej padyshim; mbasi atyre që nuk kanë kaluar kalvarin tonë u ka mbetur gjithashtu edhe një dokumentacion më i pasur, ndërkohë që dihet fort mirë se turqit osmanë kanë lënë në Shqipëri tokë të djegur (dokumentuar qartë në rastin e ripushtimit të Shkupit dhe Shkodrës (1478), kur dy qendrat e mëdha kryengritëse shqiptare që bënë qëndresë dhe pas pushtimit, u shkatërruan barbarisht bashkë me gjithçka që vlenë). Kështu, edhe pse anonim, sot duhet t'i jemi mirnjohës atyre që ndaluan që i njëjti fat t'i priste dhe objektet në fjalë duke i marrë me vete e duke i çuar në thellësi të "territorit katolik".

Problemi është se kjo heraldikë nuk njihet as në Shqipëri për të njëjtën arsye,

zhdukja e gjithshkaje, por ajo "flet" vetë përmes vizatimeve të shenjura në të. Në brendësi të heraldikës, në pjesën saj të "nderit", gjendet edhe një heraldikë tjetër por këtë radhë jo anonime. Heraldika në fjalë, që gjendet në shumicën e ndërtesave mbretërore a kështjellave në Spanjën e sotme, vjen pikërisht nga shekulli XV, kohë kur Mbretëria e Aragonës u bashkua me atë të Spanjës (Castilia&Leon) dhe gjendet aty për të na rirrefreskuar kujtesën se Shteti Shqiptar në kohën e Scanderbeg kishte lidhur një marrëveshje vasaliteti (partneritet quhet sot) me Aragonën.



Ballafaqim i heraldikës në parzmorë me heraldikën në Kështjellën e Segovijas

Kështu, ndërsa vetë spanjollët përjashtohen sepse ata nuk e kanë shqiponjën dykrenore, ka një arsye preçize (marrëveshja dypalëshe) përse në qendër të heraldikës "anonime" gjendet edhe një heraldikë të kësaj mbretërie. Ky është element shtesë që betonon lidhjen trinome Shqiponjë e zezë - Heraldikë (e panjohur) - Heraldikë e Mbretërisë së Spanjës të shek. XV.

Shqiponja dykrenore me heraldikën spanjolle (spanjollët vetë nuk kanë kurrfarë lidhjeje me shqiponjën dykrenore) i jep kuptim edhe heraldikës së panjohur; ajo qëndron si një lidhëse mes simbolit të Scanderbegut (shqiponjës) dhe heraldikës së Mbretërisë së Spanjolle, duke qenë heraldikë e asaj që unë do ta quaja me termin e përgjithshëm, Heraldika e Shtetit të Parë Shqiptar të njohur ndërkombëtarisht. Historianët tanë, më mirë se kushdo, mund të saktësojnë se me çfarë titulli paraqitej Scanderbeg nëpër kancelaritë e Europës, mbret, princ apo diçka tjetër ku ai shpallej si udhëheqës i shqiptarëve dhe duke patur në zotërim të paktën edhe Maqedoninë dhe Epirin.

Me shumë gjasë vetë kjo parzmorë kali është punuar në Spanjë, Madrid apo Barcelonë, dhe jo vetëm, sepse dhe fakti që thumbin luftarak të pikturuar në gjurin e Scanderbeg në gravurë e gjejmë në një armaturë spanjolle, mund të na japë të drejtë të hamendësojmë se i gjithë kompleti luftarak i Scanderbegut të ketë ardhur prej andej (këtu e kam fjalën edhe për përkrenaren dhe shpatën ceremoniale). Te kjo e fundit, shpata, diku pranë dorezës, ka gjithashtu disa ornamente që me të gjitha gjasat duhet të jenë punuar nga e njëjta dorë me atë që ka punuar në parzmoren e kalit. Mjafton një krahasim mes tyre nga specialistë për të nxjerrë përfundime më të sakta.

Shënim: Heraldistët tanë thonë se egziston Emblema e "Mbretërisë Shqiptare" nën sovranitetin e anzhuinëve e fundit të shek. XIV. (Shqipëria.com, Heraldika shqiptare)

Shënim: Andrea Topia pas martesës me franceze futi elementë të heraldikës franceze; kështu, shqiponjës dykrenore

i shtoi edhe yllin me gjashtë cepa të Balshajve nga kishte varësi.

Shënim: Nipi i Scanderbeg shtoi një trekëndësh, simbol i trinisë së shenjtë.

\*\*\*

Nëse bëjmë një përmbledhje dhe ballafaqojmë faktet mund të themi:

Objektet janë të epokës mesjetare dhe Scanderbeg ka qenë një prijës i shquar mesjetar, në mos më i shquari i kohës, në radhë të parë si ushtarak.

Asnjë nga pajimet ushtarake, bile as trupi i Scanderbeg, nuk gjenden në vendvarrimin e tij në Lezhë, pra çdo gjë e tij është hequr prej aty, ndërkohë përkrenarja dhe shpata ceremoniale e tij është gjetur, identifikuar dhe mbahen në Muzeun e Vjenës, pranë vendit ku janë gjetur edhe objektet në fjalë.

Objektet janë gjetur në 1500-ën, pra pas vdekjes së Scanderbegut, jo para ose gjatë jetës së tij dhe kanë gjithashtu karakter ceremonial.

Të dy objektet kanë qartazi simbolin e shqiponjës së zezë, emblematike kjo për Familjen e Kastrioteve, nën simbolet e të cilëve kanë luftuar shqiptarët asokohe, si dhe mburojën e kuqe.

Heraldika në parzmorë nuk i përket askujt deri sot, por lidh qartazi Kastriotët (shqiponja e zezë) me Mbretërinë Spanjolle (heraldika në qendër).

Të katër objektet janë në një zonë katolike, pra aty ku besnikët e Scanderbeg, por dhe të afërm të tij, mund të kenë shkuar për të gjetur mbështetje e sigurt për t'i shpëtuar përndjekjes së otomanëve që pushtuan vendin pas vdekjes së heroit dhe që mund t'i kenë marrë ato me vete që t'i shpëtonin bastisjeve.

Përfundimisht dhe me bindje të plotë do të thoja se sot kemi në Musée de Armée, Paris:

1 - Mburojën e Heroit tonë Kombëtar, Georg Castriota Scanderbeg.

2 - Parzmoren e kalit të tij legjendar.

3 - Heraldikën e parë të një shteti shqiptar të njohur ndërkombëtarisht.

Ndërsa autori i këtij shkrimi ndien detyrimin të bëjë me dije publikisht atë që vlerëson se përbën pasuri për trashëgiminë tonë, duke u përpjekur të bëjë edhe shpjegimet përkatëse, është i vetëdijshëm fort mirë se ato që kanë autoritetin shkencor dhe zyrtar të analizojnë dhe të shpallin vërtetësinë ose jo të zotëruesve autentikë të relikteve në fjalë janë specialistët e fushave dhe institucioneve përkatëse, në këtë rast në Shqipëri dhe Francë, ministritë respektive të kulturës, pse jo edhe ambasadat e të dy vendeve, që mund të bashkërendojnë punët.

Deri më tash, shumë specialistëve tanë që ua kam parashtruar materialin u ka ngjallur interes dhe më kanë mbështetur; sakaq, ndonëse i jam drejtuar institucioneve tona, kam gjetur heshtje të pashpjegueshme. Le të presim me durim dhe me bindje se këmborët...

Arben Mehli Agolli

# “Më nxit një libër!”

NË KUADËR TË DITËS BOTËRORE TË LIBRIT, MË 21 PRILL, NË ORËN 11.00, U ZHVILLUA EDICIONI I TRETË I AKTIVITETIT “MË NXIT NJË LIBËR!”



Fjalën e hapjes e mbajti drejtoresha e këtij institucioni, znj. Alida Luka. Pas urimeve për Ditën Botërore të Librit dhe përshëndetjes së rastit, znj. Luka shtoi: “U bënë disa vite që Dita Botërore e Librit në bibliotekën tonë ndërtohet mbi dy boshte: “Më nxit një libër” dhe “Biblioteka e dyerve të hapura”. Pikërisht nga këto dy drejtime gjenerojnë aktivitete të shumta e të larmishme. 23 prilli është një ndalesë tek libri, për librin e me librin. Është si një thirrje globale që i drejtohet më së shumti të rinjve që të mos reshtim së lexuari libra.”

Më pas, organizatorja dhe moderatorja e aktivitetit, znjsh. Arjeta Ferlushkaj, foli për hapat e parë të kësaj nisme: “E filluam këtë rrugëtim në vitin 2013, si një nevojë e domosdoshme për të komunikuar me njëri-tjetrin dhe për të shkëmbyer ide dhe sugjerime se çfarë duhet të bëjmë që të nxisim sa më shumë leximin. Vit pas viti, ky aktivitet asnjëherë nuk pat një format të ngurtë, përkundrazi.”



Në vazhdim të fjalës së saj, znjsh. Ferlushkaj i prezantoi auditorit ecurinë e dy edicioneve të para dhe pastaj mënyrën se si ishte ideuar sivjet ky takim.

Në pjesën e parë, të pranishmit ndoqën episode nga jeta e disa shkrimtarëve të shquar botërorë si D. Alighieri, Ch. Dickens, V.Hugo etj., që u sollën nga studentët Danjela Pjetri, Bardha Metaj dhe Senad Tula; si dhe fragmente nga vepra e H. de Balzac, M. de Cervantes, L. Tolstoi dhe Ë.Shakespeare që u lexuan nga studentët: Erisad Lugaj, Edër Boshnjaku, Bukurosh Dervishi, Sidita Hasaj dhe Besard Jacaj.

Pjesa e dytë e këtij aktiviteti i ishte rezervuar njohjes më nga afër dhe promovimit të disa nismave qytetare që punojnë për ta bërë më të afërt e më të dashur librin. Të ftuar në panel ishin përfaqësueset e katër qendrave rinore/kulturore që i kanë kushtuar vëmendje të posaçme librit dhe leximit: znjsh. Elona Culiq, përfaqësuese e “Arkës”, znjsh. Shehiada Piraniqi, përfaqësuese e Zyrës së Informimit të Bashkimit Europian në Shkodër, znj. Eri Omari, përfaqësuese e “Eko Mendje” si dhe përfaqësuesja e “Koltrinës”, znj. Suada Proda Lepuroshi. Secila nga të ftuarat prezantoi para auditorit projektet/aktivitetet që kishin zhvilluar dhe sidomos ato që do të bëheshin në të ardhmen, duke i ftuar të rinjtë që të ishin pjesë aktive e veprimtarive të tyre.

Aktiviteti u mbyll me shfaqjen e një videoje në të cilën interpretonte artisti Reshat Arbana, bashkë me një fëmijë. Poezia e interpretuar ishte “Në mundsh” (R. Kipling) dhe qëllimi ishte të përcillej mesazhi: para klasikëve të mëdhenj të letërsisë, ne jemi si fëmija para mjeshtrit, në endje për të mësuar gjithnjë.

Qëllimi i këtij aktiviteti me të gjithë komponentët përbërës është që të nxitet leximi, të afrohen sa më shumë lexuesit pranë sallave apo këndeve të leximit por edhe të promovohen ata që bëjnë të mundur pasurimin e rrugëve që të çojnë tek libri.

**Përgatiti Arjeta Ferlushkaj**

## Ndahet nga jeta gazetari i mirënjohur Ramadan Bigza



Në mënyrë të pa pritur në një rrugë të Athinës si rezultat i një ataku kardiak ndërroi jetë gazetari Ramadan Bigza. Lindi 64 vjet më parë në Shkodër në një familje puntore të qytetit verior. U shkollua në qytetin e tij të lindjes. Që i ri filloi punën si puntor në uzinën e telave. Njëkohësisht filloi të bashkëpunojë si korrespondent vullnetar i organeve të shtypit.

Duke parë aftësitë e vjet tija në këtë fushë u emërua redaktor në gazetën lokale «Jeta e Re» ku punoi për disa vite. Më vonë u përkushtua me pasion kronikave e komenteve sportive gjë që e qoi me punë në gazetën «Sporti Popullor». -Për 20 vjet rresht derisa vdiq bashkë me familjen u vendos në Greqi, ku nuk pushoi aktivitetin në shërbim të sportit shqiptar me komente e shkrime të tjera. Njëkohësisht asnjëherë nuk i preu lidhjet me Shqipërinë e duke nderuar Shkodrën e tij ku vinte shpesh. Ramadan Bigza në vitet e pjekurisë moshore profesionale zhvilloi një veprimtari të dendur gazetash. Bashkëpunoi me gazetën «Sporti Shqiptar» me gazetën «Gazeta e Athinës» që trajtonte problemet e emigracionit e së fundi punoi për gazetën «Albania Press» si kryeredaktor i saj. Ai u tregua aktiv në trajtimin e problematikës që shqetësonte emigrantët shqiptarë në Greqi. Varrimi iu bë në vendlindje Shkodër. Morën pjesë në ceremoninë e varrimit gazetarët nga Shkodra, Tirana e Diaspora. I pari mori fjalën gazetari Gac Marku që bëri një vlerësim të aktivitetit të Ramadan Bigzës. Pastaj foli kryetari i unionit të gazetarëve të Shqipërisë Aleksanër Çipa, i cili foli për meritat e kontributin e dhënë në shtypin shqiptar. Në ceremoninë mortore foli edhe gazetari i Radio Tiranës Defrim Met'hasani. Në fund mbajti një fjalim përfaqësuesi i emigracionit shqiptar në Athinë. Më herët në mjediset e prefekturës Shkodër u bënë homazhe para trupit të Ramadan Bigzës nga miq, kolegë, të afërm e qytetarë të Shkodrës. Kështu komuniteti i gazetarëve të veriut humbi një koleg të denjë dhe të paharruar të shtypit shqiptar dhe familja njeriun e dashur të tyre.

Përgatiti për gazetën «Dukagjini», Zef Nika

# PËRFAQËSIMI DINTOZ I DUKAGJINIT, NË KËSHILLIN BASHKIAK TË SHKODRËS

Që herët në malësi ka qarkulluar shprehja, se "... duhet me qenë me kë të sundojnë kalanë!". Sigurisht jo në drejtimin negativ duke bashkëpunuar me pushtuesit, por duke kontribuar me të gjitha forcat për zgjidhjen e problemeve dhe halleve të shumta që Dukagjini ka pasur. Në shtatë dekadat e fundit kanë qenë të shumtë dukagjinast me detyra të ndryshme partiake e shtetërore deri në rangjet e larta, drejtues ndërmarrjesh e institucionesh të ndryshme, të cilët kanë asistuar në vendimmarrje, u është dhënë mundësia të ngrejë zërin, por pak kanë bërë për Dukagjinin, përpjekja e tyre ka qenë më shumë në ruajtjen e karriges. Të tillë të shumtë kanë qenë edhe në dekadat e fundit, të cilëve u është dhënë mundësia të kontribuojnë për Dukagjinin në zgjidhjen e shumë problemeve e plotësimin e shumë nevojave që Ai ka pasur dhe ka, por pak kanë bërë deri tani, për mos me thënë fare.

Me ndarjen e re administrative, bashkia e Shkodrës ka një shtrirje shumë të gjerë, nga bregdeti i Velipojës deri në bjeshkët e Thethit. Përveç në tri njësi administrative nga pesë që Dukagjini, ka edhe në të gjitha njësitë e tjera të bashkisë së re, që banojnë dukagjinast, diku më shumë e diku më pak, me halle shumë e problematika të ndryshme.

Sot, për fatin tone të mirë, aty ku merren vendime të rëndësishme, që ndikojnë në jetën e këtyre banorëve, siç është këshilli bashkiak, kemi një përfaqësimit shumë dinjitoz si në sasi, në të cilin përbëjnë afër ¼ e këshilltarëve, por edhe cilësi formimi. Më poshtë po jua paraqesim të 9 këshilltarët dukagjinast, pjesë e këtij Këshilli, të cilët na bëjnë optimist, se kontributi i tyre në të mirë të Dukagjinit nuk do të mungojnë.

## GRETA BARDELI (GJONI)

E bija e "Pishtarit të demokracisë", e mjeshtër të sportistit dhe trajnerit të suksesshëm z. Zef Gjoni. Martuar në një ndër familjet më me emër në Shkodër. Përveç se është anëtare e këshillit bashkiak, është zgjedhur me vota maksimale Kryetare e Këshillit të Qarkut Shkodër. Ka mbaruar arsimin e lartë në jurispruencë, në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër. Master i nivelit të dytë "E drejta ndërkombëtare private". Është pedagoge në fakultetin e drejtësisë në universitetin e Shkodrës. Kandidate për doktoraturë. Angazhohet në disa organizma ndërkombëtare si: Presidente e Tsak-Force për EUSAIR CPMR – konferenca periferike për mbrojtjen e zonave bregdetare të Europës dhe anëtare e komitetit drejtues Eurorajoni Adriatiko – Jonian. Flet italisht e gjermanisht.



## MARK RUPA

Mark Rupa, është nga një familje me emër shumë të mire, nga Thethi. Është anëtar i Këshillit Bashkiak dhe anëtar i Këshillit të Qarkut Shkodër. Mbas mbarimit të shkollës pyjore në Shkodër, merr diplomën "inxhinier pyjesh" në Universitetin Bujqësor, në Tiranë. Në universitetin e shkencave të aplikuar Ebersälde Gjermani përfundon master në shkencë me temë: Teknologji informacioni mbi ekosistemet pyjore ndërkombëtare. Është kandidat për doktor i shkencave në fushën e biodiversitetit. Zotëron shkëlqyeshëm gjuhën angleze dhe mirë në të folur e shkruar gjermanisht e italisht. Është përdorues Professional i programeve kompjuterike në të gjitha sistemet. Ka një eksperiencë të pasur profesio-



nale duke u aktivizuar në shumë institucione kombëtare e ndërkombëtare si: Këshilltar në menaxhimin e buri-meve natyrore në CNVP- Bashkojmë vlerat mjedisore me njerëzit; projekt koordinator in south East Europ Eberälde Gjermani; këshilltar në SNV-organizata holandeze për zhvillim; specialist në hartografi dhe planifikim urban, punë kërkimore në fitogrametritin pyjore në universitetin bujqësor Vashave e të tjera.

## NDOC ASHTA

Anëtar i këshillit bashkiak në disa legjislatura, pasardhës i denjë i një prej familjeve më fisnike e antikomuniste jo vetëm të Shoshit, por të Dukagjinit e më gjerë siç është ajo e Lulash Gjeshit Ndrejaj -Shosh. Është me profesion jurist. Me shumë aftësi menaxhuese e komunikuese. Ka pasur disa detyra: Kryetar i komunës së Shoshit nga viti 1991 – 2003; pastaj ka kryer detyra të ndryshme në administratën shtetërore si: Inspektor A. R. P. P. Qarku Shkodër; drejtor i ndërmarrjes rajonale të rrugëve rurale Shkodër; gjashtë vjet në detyrën e Drejtorit, në filialin e Postës Shkodër; Drejtor rajonal i inspektoratit shtetëror të punës. Është larguar nga puna në nëntor 2013 pa shkaqe ligjore. Puna e tij kudo ka qenë shumë gjurmëlënëse. Momentalisht menaxhon një biznes privat.

## MHILL PRONI

Anëtar i këshillit bashkiak për të tre legjislaturat e fundit. Është anëtar i këshillit të Qarkut Shkodër. Vjen nga një familje e shquar për mençuri, e cila gjithnjë ka përkrah progresin. Është me profesion jurist dhe në përfundim të masterit shkencor. Është biznesmen i suksesshëm sidomos në "Prroni sh. p.k. -Shkodra Ashensor", shquhet për ndihmesën e njerëzve në nevojë. Ka aftësi të mira kompjuterike.



## VALENTINA VUKSANI

Valentina Vuksani, është bijë në një familje të nderuar Gimaj – Shalë dhe e martuar në një familje me shumë emër në Nënnavriq, në Dukagjin e më gjerë, bëmat e të parëve të të cilës janë përjetësuar edhe në këngë. Ka nënshtetësi shqiptare e kanadeze; ka përfunduar kolegjin 2 vjeçar në Kanada. Ka përfunduar Universitetin e Shkodrës dega ekonomi – turizëm si dhe masterin shkencor "Menaxhim i turizmit të qëndrueshëm", po në Shkodër. Ka punuar në Kanada si mësuese e gjuhës angleze për emigrantët dhe disa vite si agjent shitjesh në sallonin e makinave "Dodg". Që nga marsi 2014 punon si specialist pranë degës së përfitimave në sigurimet shoqërore Shkodër. Zotëron gjuhët e huaja: anglisht, gjermanisht, italisht e spanjisht.



## GJERGJ SOKOLI

Gjergj Sokoli, është nga fshati Lotaj, Shalë. Anëtar i këshillit të bashkisë Shkodër për tre mandate e në vijim.



Punon si jurist në institutin e shëndetit publik Shkodër dhe për shumë vite e në vijim menaxher shumë i suksesshëm në një biznes të vogël. Ka përfunduar shkollën e lartë, Fakulteti Juridik. Për një dekadë ka punuar në organet e punëve të brendshme Shkodër. Komunikon mirë italisht si dhe ka aftësi të mira kompjuterike.

## ALDA DERMANI

Alda Dermani është këshilltarja më e re e bashkisë Shkodër. Pasardhëse e një familje në Kir të Pultit, e cila ka bërë histori në interes të Dukagjinit e atdheut. Është në përfundim të universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës, Fakulteti Ekonomik, dega administrim – biznes. Ka mbrojtur gjuhën angleze dhe është njohëse e mirë e gjuhës italiane. Punon mirë me gjuhën kompjuterike.



## GRISELDA RADOHINA

Griselda Radohina, është nga një familje me emër të mirë jo vetëm në Theth, por edhe në Dukagjin e Shkodër. Ka mbaruar Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Shkodrës, kurse në vitin 2015 ka marrë licencën e avokatisë. Punon si koordinator pranë studios ligjore "Neraxhi" Tiranë. Zotëron shumë mirë me të folur e shkruar gjuhët anglisht e italisht.



## GJOVALIN TROJA

Gjovalin Troja, është nga një familje e mirë në Abat Shalë. Na vjen keq, por, me gjithë përpjekjet e disahershme, nuk na ka vënë në dispozicion asnjë informacion nga CV-ja e tij, sepse ka qenë shumë i "zënë" me punë muajt e fundit. Kemi besim se nuk do të mungojnë angazhimi i tij në interes të Dukagjinit.

Shpresojmë se 9 këshilltarët dukagjinast në bashkinë Shkodër, tre nga të cilët janë edhe anëtar të Këshillit të Qarkut, do të jenë një zë i fuqishëm në mbrojtjen e interesave të dukagjinastve kudo ku janë, në zgjidhjen e problemeve që ata kanë. Ata do të llobojnë në vendimmarrje sidomos për infrastrukturën rrugore, zhvillimin e turizmit, përmirësimin e kushteve në shkollë, përmirësimin e shërbimit shëndetësor e të tjera, duke u bërë një edhe pse përfaqësojnë subjekte të ndryshme politike. Mos të ndodhin që kur merren vendime të rëndësishme të mungojnë siç ndodhi me dhënien e emrit të shkollës në lagjen "Mark Lula". Shembulli pozitiv dhe eksperiencë ekziston nga këshilltarët e legjislaturave të kaluara, sepse disa këshilltar, edhe pse të pakët në numër, kanë qenë shumë lobues e kontribuues në vendimet në favor të vlerësimit dhe dhënies të vendit që meritojnë të shumë figurave dukagjinase, në mbështetje të propozimeve të shoqatës "Atdhetare Dukagjini" sidomos nga Mhill Prroni e Ndue Maraçaj. Të gjithë duhet të frymëzohen e të marrin shembull nga kryetarja e qarkut z. Greta Bardeli, e cila e ka gatishmërinë maksimale për ti prituri në çdo kohë dukagjinast dhe përpiqet për tua zgjidhur problemet që kanë. Edhe në njësitë e tjera administrative ka dukagjinast këshilltar si: Ndoc Leka në bashkinë e Vaut të Dejës, Lula Botina në Malësinë e Madhe e të tjerë, ku nuk do të mungojë kontributi i tyre.

Dukagjini nuk ka qenë kurrë më i përfaqësuar në organet vendimmarrëse e administratën shtetërore lokale dhe shpresojmë se do ta shfrytëzojmë këtë mundësi të artë në interes të Dukagjinit dhe dukagjinastve.

PRELË SHYTANI

# AKULLORE FEST 3

## PRANVERË ME KËNGË DHE AKULLORE NË FESTIVALIN E FËMIJËVE NË SHKODËR

U mbyll me sukses nata finale e Festivalit lokal "Akullore Fest" 3, që, megjithëse u zhvillua në një sallë me përmasa më të vogla se ajo e teatrit "Migjeni" siç është ajo e koncerteve "Gjon Kapidani" në Shkollën e Mesme Artistike "Prenke Jakova" në Shkodër, nuk i zbehu meritat e një pune të jashtëzakonshme të përkushtuar të organizatorëve nën drejtimin e z. Anton Kaftalli, drejtor organizativ i këtij festivali.

Çdo gjë ishte gati. Salla e tejmbushur priste ashtu siç dinë të presin spektatorët shkodranë hapjen e siparit, ku me tingujt e këngës hit "Akullorja" të kompozitorit shkodran, të paharruarit Mark Kaftalli filloi edicioni i tretë i festivalit "Akullore Fest" kaq të shumëpritur nga artistët, fëmijët dhe prindërit.

Me një zgjidhje gazmore plot sportivitet, shoqëruar nga duartrokitjet dhe ovacionet nga dera e sallës, në drejtimin e skenës vërshuan fëmijët si në një livadh ku lodrojnë, duke vrapuar edhe duke u rreshtuar në dy anët e një podi rrethor, ku do të performonin këngëtarët për të plotësuar kështu skenografinë e thjeshtë e domethënëse të këtij spektakli.

Ulur në karrike para legjive, një grup instrumentistësh, djem e vajza, nuk ishin orkestër e përbërë nga emra të mëdhenj, por një trupë e talentuar nxënësish jo më shumë se 15 vjeçar, që atë natë e ndjenin veten me përgjegjësi të madhe, siç mund ta ndjejë një instrumentist, pse jo në koncertin e Vjenës.

Hyrja në skenë e dy prezantuesve Astrit Fani me përvojë në këtë fushë dhe Anisa Meshnuni në hapat e saj të parë, si këngëtare dhe prezantuese spektaklesh, me zhdërvjellsinë e tyre krijuan përnjëherë një "urë lidhëse" me publikun në sallë, që do të shoqëronte shfaqjen deri në fund të saj.

Materiali muzikor dhe letrar, interpretimet e këngëtarëve të vegjël, të përzgjedhura nga 27 këngët konkurrese të natës së parë, erdhën në finale si një repertor, ku njëra këngë ishte më e bukur se tjetra dhe siç është traditë, juria e përbërë nga profesionistë të nderuar, nën drejtimin e shkrimtarit të shquar Fadil Kraja "Mjeshtëri i Madh" dha verdiktin për krijimtarinë më të mirë, duke akorduar tre çmime të treta, dy të dyta dhe çmimin e parë.

Përgatitja në këtë mënyrë e brendësisë së festivalit tregonte seriozitetin me të cilin ishte punuar nga stafi artistik me drejtues z. Anton Kaftalli, që jo vetëm është ideatori, por ka meritë të veçantë, sepse rikthej për të tretin vit radhazi një festival, i cili kishte kohë që nuk organizohej. Mirëpo fidanishtja me fëmijë të talentuar të Shkodrës kishin nevojë për të dhe z. Anton Kaftalli e risolli këtë traditë të freskët dhe të këndshme si vetë akullorja, që aq shumë e duan dhe e shijojnë fëmijët.

Me punë të palodhur dhe me shumë profesionalizëm u paraqitën kompozime dhe orkestrime nga Xhavit Ujkani, Andi

Unaza, Ilir Zogaj, Gazmend Kraja, Zaim Mërkulaj, Rezart Cacani, Artion Qamili, Islam Axhemi dhe Arsid Çeka.

Në këtë shkrim nuk marrim përsipër të bëjmë një analizë artistike të "Akullore Fest" 3, pasi për këtë u shprehën me fjalë të lavdërueshme specialistët e kësaj fushe, por në këtë kontekst zënë vënd fjalët aq të dashura që tha në këtë natë shkrimtari dhe dramaturgu i shquar prof. Fadil Kraja "Mjeshtëri i Madh" i cili u shpreh: "Ky festival na kujton shumë emra të nderuar kompozitorësh shkodranë me përmasa kombëtare në krijimtarinë e tyre të ndritur për fëmijë, si: Prekë



Jakova, Mark Kaftalli, Leonard Deda, Zef Lekaj, Zydi Barbullushi, Xhavit Ujkani, Koleç Gajtani etj.

Në themelet e asaj kështjelle të madhe të kulturës dhe artit që Shkodra në shekuj ka vënë, një gur i çmuar, një gur i rëndësishëm dhe i përjetshëm është edhe Mark Kaftalli.

Një proverbë e vjetër thotë: "Ban babë se të ngjas dhe një pëllëmbë ta përshkas" u shpreh shkrimtari i madh Fadil Kraja dhe këtu e kishte fjalën jo vetëm për Anton Kaftallin, djalin e Matk Kaftallit, por edhe për djalin e bilbilit të këngës popullore shqiptare Bujar Qamili, që është Artion Qamili, i cili është paraqitur në këtë Festival me një krijimtarinë të shkëlqyer dhe pretenduese për çmim.

Profesor Kraja foli me shumë superlativa për familjen Fani, ku ndër të tjera moderatorin e Festivalit Astrit Fani e quajti si "Shoëmen".

emi mësuar ta quajmë Shkodren djep i kulturës dhe artit: Ja orkestra e fëmijëve, ja fëmijët e mrekullueshëm. Nuk na mbetet gjë tjetër veç të themi kjo është Shkodra. Nuk na mbetet gjë tjetër veç të themi faleminderit Shkodër".

Më duhet të përmend këtu edhe mësuesin e letërsisë, por dhe krijues në këtë fushë që në rini, i shquar për krijimtarinë për fëmijë z. Osman Kozmaj, në këtë organizim, me dëshirën që e zgjojnë kujtimet në punën që ka bërë me fëmijët në

shkollë, shtëpi kulture, apo në qendrën kulturore të fëmijëve në Shkodër, me ndjesinë që provon njeriu në një eveniment të tillë mes luleve të pranverës, ishte edhe vetë pjesëmarrës, ndjehej më i ri dhe shumë i lumtur, pasi zuri një vend të nderuar, duke u vlerësua me çmimin e dytë të festivalit.

Një kënaqësi të madhe solli tek spektatorët dalja në skenë e këngëtares 4-vjeçare, më e vogla e Festivalit Klara Daberdaku, për të cilën tregon kompozitori i saj Artion Qamili se: "Gjatë regjistrimit të këngës në studio ajo e ndalonte këngën herë pas here, duke pyetur për kuptimin

pak çaste e publikut siç ndodh zakonisht e zgjidhën enigmën në çastin që filluan publikimet e këngëve fituese të cilat u deklaruan nga goja e antarëve të jurisë, por edhe të ftuarëve VIP në skenë z. Zef Çuni Zv. Ministër i Kulturës, i cili dorëzoi mirënjohjen për kontributin e dhënë për krijimtarinë për fëmijë ndër vite shkrimtarit të shquar Paulin Shtjefni.

Me të njëjtën mirënjohje, ky festival nderoj edhe mjeshterin Zef Lekaj, të cilën ia dorëzoi përfaqësuesja e drejtorisë arsimore në Shkodër znj. Elira Smakaj.

Në festivalin "Akullorja Fest" edicioni i tretë u dhanë tre çmime të treta.

1- "Lahet bebi", teksti: Ramazan Çeka, muzika: Arsid Çeka, orkestri: Andi Unaza, kënduar nga Elena Babani.

2- "Zogu pushverdhë", teksti: Lindita Cungu, muzika: Franc Luci, orkestri: Artion Qamili, kënduar nga Rigera Loka.

3- "Gjuha nënës gjuha ime", teksti: Ramazan Çeka, muzika dhe orkestrimi: Xhavit Ujkani, kënduar nga Sonila Molla.

Dy çmime të dyta:

1- "ABC", teksti: Osman Kozmaj, muzika: Zaim Mërkulaj, orkestri: Andi Unaza, kënduar nga Kristi Ndoja.

2- "Unë dhe kali", teksti: Brunilda Gajtani, muzika: Oleg Gjerga, Orkestri: Artion Qamili, kënduar nga Bruna Kaqi.

Çmimi i parë

1- "Të duam të mirë", teksti: Ramazan Çeka, muzika dhe orkestrimi: Artion Qamili, kënduar nga Anxhelo Preçi.

Ky çmim u dorëzua nga shkrimtari i shquar Fadil Kraja, "Mjeshtëri i Madh".

Kënga fituese u prit me duartrokitje dhe ovacione femiore në sallë dhe siç është tradita u këndua edhe një herë, për të përmbyllur me sukses këtë eveniment kaq të arritur dhe të këndshëm.

Për realizimin e festivalit të fëmijëve "Akullore Fest", nën drejtimin e z. Anton Kaftalli, drejtor organizativ, u angazhua një staf profesionistësh, duke filluar që nga udhëheqësja artistike Vjola Bajraktari e për të vazhduar me radhë me skenografinë e Elvis Buraniqit, me prezantimin e dy moderatorëve Astrit Fani dhe Anisa Meshnuni, një spektakël i vënë në skenë dhe i realizuar nga dora e regjisorës shkodrane, të mirënjohurës Rita Gjeka, njëkohësisht edhe drejtoreshë e Teatrit "Migjeni".

Këtë spektakël të kësaj mbrëmje magjike e xhiruan edhe televizionet lokale të qytetit të Shkodrës, Shkodra TV1 Channel dhe Tv Rozafa me regji të përbashkët.

Prindër dhe figura të njohura të qytetit të Shkodrës me kontributin e tyre kanë qenë gjithmonë pranë evenimenteve artistike, aq më shumë kur bëhet fjalë për fëmijë, por më pranë këtij festivali këtë radhë ishin edhe ata që zakonisht quhen sponsor dhe për kontributin e tyre u falenderuan publikisht gjatë festivalit. Ata vinin nga jeta tregtare dhe private si, Amined shpk dhe Caty Foundation.

Post festivali ishte një shfaqje më vete, pasi në skenën e sallës "Gjon Kapidani" u ngjiten fëmijët, prindër, të ftuar, artistë, të cilët me tingujt e këngës "Akullorja" përshëndeteshin njëri me tjetrin dhe bënë foto për t'i publikuar ato në statuset e tyre si një kujtim i paharruar i kësaj nate magjike.

RAMAZAN ÇEKA

## poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi

**BILETA**

Nuk mbrriti me zbardhë ky mjes si tjetër herë!  
Te kopshti pa vadë derdhi veç do pika shi -  
pikllim qiejsh i tretun n' kujtesën e ajrit.  
Nëpër muzg  
hana e thyeme mbi çati  
s'ka me harrue kurrë  
numrin e një bilete lamtumire  
t' lanë kastile mbi shtrat,  
si sajësë e një stine me stuhi.  
Kur lujshim kukamshehë dikur,  
te oborri i rinisë mbulue me harresë ,  
vend – maskimi im  
asnjëherë nuk ishte i sigurtë  
e ti gjithmonë strofkën e para ma pate gjet.  
Ulërin naltësive një avion  
si shpend i tretun nëpër botë  
e një patë e egër epikën e maleve kërkon  
për çerdhën e shembun mbi tokë.  
Te xhami i thyem i qiellit  
n' mjegull mbështjell  
fluturon horizontëve t' lindjës  
trishtueshëm e krejt vetëm një biletë.  
*Ndoc Selimi*

**MBRËMJES I SHKRUAJ PËR TY!****1. ASAJ**

Mirësevjen malësore  
Një copë herë . . .  
Shije pranverore  
Zbukuron qiellin.

Lexoj ëndrrat  
Në krah të kundërt  
Një krijesë bash si EVA  
Ushqyer me zjarr puthjesh.

E përkëdhelura muzave.

**2. Jo më si DIKUR...**

Shkoklohet vesa memece  
Mbi çati e kalldrëme  
Në vendin e vjetër...

Nga një shtëpi e lashtë  
Zoti të zgjodhi ty.

Tashmë për gjithçka  
Duhet hapur rruga

Kjo shetitore  
Jo më si DIKUR...

**3. Udhëtarët e RRUGËS!**

Kondenën delet  
Gjithandej në Vërmosh.

Në kulmin e natës  
Çobani nuk fle  
dhe ne shoqërojmë borën.

Era lozonjare  
Uragan mbi kaçurrela  
Trumhasën ëndrrat.

Doli në pah baresha  
Zgjodhi faqen e malit  
Tufa me dele

Ndërsa zemra e saj  
Tamël i bardhë...

Ndjejnë udhëtarët e rrugës  
Krismat e buzëve...

**4. Ah grua e DASHUR!**

Ah grua  
Megjithatë  
Ndjehem tejet e lumtur...

Jo vetëm për mua  
Por edhe tri jetë të kemi  
Se kompensojmë shpirtin.

Në mes të ëndrrave  
Ti erdhe me porosi  
Dashuri e Yllëzuar...

**HAIKU**

1  
Imazh i bukur  
Koha e fluturave  
Çast i magjepsur.

2  
. . .dhe mali lindi  
Një mi të pabindur  
Gazevaj o njerëz.

3  
Boll mme telashe  
Xhaxhai vjen pash më pash  
Koh' e kahershme.

4  
Moll' e uruar  
Je xhane për flutura  
Fërfëllon shpirti.

5  
Lajmotivi im  
Ku i del ama Drinit  
Shkoj për të parë.

6  
Mbreh vala gjuhën  
Duke i folë shqip Bunës  
Tundoj Obotin.

7  
Fill te manjola  
Bilbilit i zë dora  
Kërkon lulëkuqen.

8  
Era nga prroskat  
Zvarritet gjer në ballkon  
Kukuris lulja.

9  
Ksulën mbi sy  
Rrugës deri në Prizren  
Diell' i bukur.

10  
Cukali ka hak  
Emrin e kahershëm

Logu i Shllakut.

11  
Gjithë vera shi  
Misri një bojë njeriut  
Koha e gjelbërt...

12  
Diell i hershëm  
Mollat shend e verë  
Faqet e kuqe...  
*LAZËR PREKA*

**MAJI I LULEVE**

Muaji i luleve,  
Muaji i kangëve, i muzikës,  
I artit e dashurisë, i dashnorëve,  
Por edhe punëtorëve e dëshmorëve.

Bora shkrinë,  
Prrojet gurgullojnë,  
Natyra qeshë, pemët lulëzojnë,  
Bletët fluturojnë lule në lule,  
Nektarin mbledhin, në mjalhtë e kthejnë.

Në mbramjet e tua të bukura,  
Ndër lulishte plot me lule,  
E dashnorëve u afrohet dekiku,  
Për këto çaste këndoju Pjerin Ashiku.

Kanga shkodrane thot,  
"n'daç mua me më kërkua,  
Më gjenë në dranofille,  
Në daç me bisedua.

**RRETHIMI I SHKODRËS****Tetor 1912-prill 1913**

Pabesisht Evropa na ka nda,  
Na grabiti përmes diplomacisë,  
Tokat tona fqinjëve tonë u dha,  
Për hatër të Rusicë.

Në luftë titanike,  
Me forca të pabarbartë,  
Shkodranët trimnisht luftuan,  
Përball çdo sacrifice, heroikisht qëndruan.

Para asnjë vështirësie,  
Asnjë tmerr, asnjë sacrifice,  
Ata nuk u dorëzuan,  
Por nga drejtuesit u tradhtuan.

Para stuhisë dhe rebeshit, qëndruan,  
Burra, gra, pleq e të ri, si luan,  
E në luftën për liri,  
Jetën dhanë.

Esat Toptani, me vasalët e tij,  
Në besën dhe bukën e vet,  
Hasan Riza Pashën e vranë,  
Kështu realizuan tradhëtinë.

Pas vdekjes së tij,  
Ushtria u shkatërrua, mbaroi,  
E ky tradhtar me synimet e tij,  
Shkodran pushtuesit i dorëzoi.  
*NDUE MICI*

# PRANDAJ HYJI LARTËSOI..

Sakrificat njerëzore e ka një kufi. Jetën. Por mirënjohja ndaj atyre që kanë forcën e nevojshme të karakterit për t'u flijuar për arsye tërësisht altruiste, është e pakufishme.

Për këtë arsye, sado nderime që t'i bëjmë kujtimit të tridhjetë e tetë martirëve të Kishës Katolike në Shqipëri që u përndoqën pa mëshirë, u burgosën, u torturuan, u poshtëruan dhe u vranë gjatë diktaturës komuniste, ato kurrë nuk do të jenë mjaft.

Ata ishin të gjithë inteligjentë, të shkolluar në universitetet më të mira të Evropës perëndimore, dhe as që mund të vihet në dyshim se ata nuk e dinin çfarë i priste. E megjithatë, ata zgjodhën të qëndronin. Një pjesë e madhe ishin të rinj, me ndjenja të holla artistike dhe me shpirt të pastër e të bukur. Ata e donin jetën. E megjithatë, zgjodhën të mos iknin.

E dinin se sentencat e tyre filozofike do të ishin të pafuqishme përballë ulërimeve hysterike të turmës së vrazhdë dhe nuk do t'i mbronin dot. E dinin se vala shkatërrimtare e çelikut dhe e barutit nuk do të stepej as para shenjtërisë së altarëve, as para madhësisë së kambanarëve dhe as para elegancës së kubeve. Afresket e

punuara me mjeshtëri të rrallë, u varrosën nën gëlqeren e brushës qimetrahe. Ata qëndruan sepse e dinin se ashtu siç u



ringjall Krishti i munduar në kryq, ashtu edhe koha e mundimeve për Kishën katolike në Shqipëri do të soste dhe Ajo do të ringjallej. E pra, koha e Ringjalljes erdhi. Kambanoret u ringritën, kubetë u rindërtuan dhe afresket dolën sërish në dritë. Ne i gëzohemi jo vetëm jetës shpirtërore, por edhe krenarisë që Selia e Shenjtë ka

vendosur t'i shpallë të lumë të tridhjetë e tetë martirët shqiptarë brenda këtij viti. Për të kremtuar këtë arritje histor-



ike për Kishën dhe për popullin shqiptar dhe duke pasur parasysh kompleksitetin e figurës së martirëve tanë, veprimtari të shumta që po organizohen së fundmi në nder të tyre nuk kanë si të jenë njëdimensionale. Ata janë një ndërthurje mes aspektit teologjik, njerëzor, kulturor dhe artistik.

Pikërisht një aktivitet i tillë që ekspozita e pikturës "Prandaj Hyji i Lartësoi..." e organizuar nga Arqipeshkvia Shkodër-Pult dhe Komisioni Drejtësi dhe Paqe, në mjediset e Galerisë së Arteve Shkodër në 22 Qershor 2016. Një numër i konsiderueshëm piktorësh, shqiptarë dhe të huaj, i'u përgjigjen thirrjes së organizatorëve për të paraqitur punimet e tyre të frymëzuara nga jeta, vepra dhe sakrificat e martirëve. Punimet spikasin për intensitetin e ndjesive të shprehura, për larminë e rrymave artistike dhe për mesazhet edukative që përcillnin.

Pas ekspozitës, punimet do t'i nënshtrohen vlerësimit të një jurie profesionale për të përzgjedhur imazhin zyrtar të martirëve të Kishës Katolike në Shqipëri.

Nëse keni dëshirë të nderoni kujtimin e martirëve tanë në një mjedis shumë të përshtatshëm për të medituar dhe për t'u pasuruar me kulturë, një vizitë në Galerinë e Arteve për të admiruar ekspozitën "Prandaj Hyji i Lartësoi" do të ishte një zgjidhje e shkëlqyer.

Vladimir Banushi

## GËZUAR FESTAT E QERSHORIT

Në Treviso të Italisë ka një numër ma të madh të migracionit shqiptar në përgjithësi, atij kosovar në veçanti (ku sipas statistikës zyrtare vendore është i dyti për nga numri pas rumunëve), vërtetojnë edhe aktivitetet kulturore shqiptare që zhvillohen në këtë krahinë/provincë të Trevisos së Italisë.

Në fundjavën e dytë, gjegjësisht të shtunën me 11 Qershor 2016, u mbajt Mbrëmja Kulturore me rastin e përfundimit të vitit shkollor 2015 / 2016 në SHSHMP në Treviso

Me rastin e përfundimit të viti shkollor 2015/2016 Shkolla Shqipe e Mësim-it Plotësues në Treviso, së bashku me prindërit dhe komunitetin shqiptar që jetojnë në këtë lokalitet, të shtunën me 11 qershor 2016 nga ora 20.00, në Quinto di Treviso, organizoi mbrëmje kulturore me moton GËZUAR FESTAT E QERSHORIT!

Të pranishëm ishin zyrtar nga organet vendore komunale e regjionale, si: z. Fulvia Pettina, z. Mauro Dal Zilio, Don Roberto, Don Matteo, Vincenzo Schiolarbreshë, etj. Ndërsa mysafirë i veçanët, i ardhur enkas për këtë aktivitet nga Kosova, ministri i Diasporës në Republikën e Kosovës, z. Valon Murati, dhe zonja Remzije S. Makolli, të cilët ishin të mirëpritur jo vetëm nga drejtuesit e shkollës shqipe, por edhe nga komu-

niteti shqiptar edhe ai vendor që ishte i pranishëm. Gjithashtu nderuan me prezencën e tyre edhe kryetar shoqatash e mësues shkollash të rajonit, etj. Në pamundësi që të jetë prezent Guvernatori i



Regjionit Luca Zaia, dërgoi një letër falënderuese për ftesë dhe duke i inkurajuar mësuesit për këtë aktivitet.

Në sallën e Oratoriumit në Quinto(TV), me binën e pajisur me flamuj: Kombëtar Shqiptar, shtetëror i Kosovës dhe ai italian, pllakati i Shkolla Shqipe e MP – Treviso dhe dy pankarta ku shkruhet: "Gëzuar Festat e Qershorit" dhe "Gjuha Jonë...!".

Fillimisht u kënduan tri himnet: Kombëtar Shqiptar, Shtetëror i Kosovës dhe ai Italian. Derisa himnin kombëtar dhe

atë Italian e kënduan kori i nxënësve të shkollës shqipe në dirigjimin e Eliza Begaj-gjithashtu nxënëse, himni shtetëror i Kosovës në mungesë teksti u dëgjua si incizim. Këtë mbrëmje kulturore e drejtoi mësuesja Malsore Shaqiri, dhe në momente të caktuara edhe Ilaria Cazzaro, vijuese italiane e shkollës shqipe.

Në emrin e shqiptarëve që jetojnë në këtë lokalitet e bëri një paraqitje mësuesi Bajram Desku, në shqip dhe italisht, ku në fund të paraqitjes së tij së bashku me ministrin Valon Murati, dhuruan një dhuratë për organet kishtare të cilën e pranoi Don Roberto.

Ministri Valon Murati, ishte i pari ministër që vjen enkas për një aktivitet të Shkollës Shqipe në Itali. Andaj edhe i dha një karakter jashtëzakonisht të veçantë kësaj mbrëmje dhe gjithë aktivitetit të Shkollës Shqipe të MP në Treviso. Ai shprehi fjalë miradije për organet vendore, komunitetin shqiptar, për mësuesit vullnetar, dhe sidomos për nxënësit që prezantuan në program që gjithsecili kishte paraqitje dinjitoze. Ministri ishte shumë konkret në paraqitje, andaj edhe mori duartrokitje të gjata nga të pranishmit.

Nxënësit patën paraqitje të mrekullueshme, herë pas here si individ, në

duete, në grupe me poezi për atdheun, gjuhën, shkollën, prindërit, dëshmorët, etj. Mandej me këngë, me recitale dhe lojë skenike. Sidomos loja skenike, kishte një mesazh të veçantë për të gjithë ata prind që hezitojnë të dërgojnë fëmijët e tyre në Shkollën Shqipe të MP.

Këngëtarët Elhame Ahmetaj Gyhelli, Feim Graishta e Musa Ahmetaj i dhanë shijen e veçantë kësaj mbrëmje, sikurse edhe grupi i valleve të Shoqatës ILIRIA Treviso dhe çifti Musaj nga Tropoja.

Koordinatori Beqir Cikaqi, njëkohësisht mësuesi të Shkolla Shqipe e MP – Treviso, iu përcollti përshëndetjet e z. Nuhi Gashi, përgjegjës për arsimin shqip në diasporë. Iu urua të pranishmëve festat e Qershorit: **1 Qershori** - Dita ndërkombëtare e fëmijëve; **2 Qershori** - Dita e republikës Italiane; **10 Qershori** - Dita e mbajtjes së Lidhjes Prizrenit dhe **12 Qershori** - Dita e Çlirimit të Kosovës. Duke i falënderuar të gjithë për pjesëmarrje në këtë mbrëmje, iu kujtoi shkurt, se Shkolla Shqipe e Trevisos është aktualisht me e fuqishmja për nga numri i nxënësve 48 nxënës/vijues dhe tre mësues vullnetar ku ka dy paralele në Paderno dhe Quinto... Dhe së bashku me ministrin Valon Murati ndan CERTIFIKATAT, për secilin nxënës/vijues. Në fund bënë një foto të përbashkët.

Pas përfundimit të programit kulturor-artistik u organizua koktej të përgatitur me ushqime nga familjet shqiptare dhe donator shqiptar.

Beqir Cikaqi, Treviso-Itali

### REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

### Mundësoi Botimin:

VATË MUSA

Dashmirës i Shoqatës Atdhetare Dukagjini, Shkodër